

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shaqë Curri, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarve F.G., nga fshati ..., Komuna e Obiliqit, për shkak të veprave penale rasteve e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, veprës penale dhunimi në bashkëkryerje nga neni 193 par.3 lidhur me par.2 nën par.1 lidhur me par.1 dhe 23 të KPK dhe dy vepra penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, B.T., nga fshati ..., Komuna e Obiliqit, për shkak të veprave penale të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, veprës penale dhunimi në bashkëkryerje nga neni 193 par.3 nën par.1 dhe dy vepra penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, A.A., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve av.F.D. dhe av.M.N., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.527/2014, të dt.20.06.2016, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 16.03.2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.G. dhe B.T., av-M.N. dhe F.D. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.527/2014, të dt.20.06.2016, Vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, PKR.nr.527/2014, të dt.20.06.2016, të akuzuarit F.G. dhe B.T., janë shpallur fajtor secili veç e veç për veprat penale edhe atë: grabitje në bashkëkryerje nga neni 255 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe dy grabitje në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, dhe iu janë përcaktuar dënimet të akuzuarit F.G., për veprën penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, për veprën të përshkruar si në dispozitivin III të dispozitivit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve, për veprën të përshkruar si në dispozitivin IV me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve.

Të akuzuarit B.T., për veprën penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, për veprën të përshkruar si në dispozitivin III të dispozitivit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve, për veprën të përshkruar si në dispozitivin IV me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve.

Në bazë të nenit 80 të KPRK, të akuzuarin F.G., e gjykon me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.18.10.2011 deri me dt.11.09.2015 dhe në arrest shtëpiak nga dt.11.09.2015 deri me dt.29.01.2016 dhe të akuzuarin B.T., e gjykon me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 4(katër)vite e 6(gjashtë)muaj. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.18.10.2011 deri me dt.11.09.2015 dhe në arrest shtëpiak nga dt.11.09.2015 deri me dt.29.01.2016.

Në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPRK, të akuzuarit F.G. dhe B.T., lirohen nga akuza për veprën penale dhunimi në bashkëkryerje nga neni 193 par.3 lidhur me par.2 nën par.1 lidhur me par.1 dhe 23 të KPK lirohen nga akuza.

I akuzuari A.A., në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP, refuzohet akuza për veprën penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Ndaj të akuzuarit F.G., konformë nenit 62 par.2 nën par.2.7 të KPK, konfiskohen dy thika, ndërsa ndaj të akuzuarit B.T., konfiskohen një palë pranga me këllëf.

Të dëmtuarit V.L., B.R., L.S., F.I. dhe B.B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit F.G. dhe B.T., obligohen që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 300(treqind)Euro secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa për të akuzuarin A.A., shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Mbrojtësja e të akuzuarit F.G., av.F.D., ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza, ose t'ia zbus dënimin ose që çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.T., av.M.N., ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza, ose t'ia zbus dënimin ose që çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe vendim.

-Prokuroria e Apelit me shkresën e saj PPA/I.nr.44/2017, të dt.19.01.2017, ka propozuar që Gjykata e Apelit ti refuzoj si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.527/2014, të dt.20.06.2016, ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit me 16.03.2017, ku morën pjesë, mbrojtësit e tyre av.F.D. dhe av.M.N., të dëmtuarit L.S., B.R. dhe përfaqësuesja e palës së dëmtuar av.L.B.-I., ndërsa në seancë nuk morën pjesë prokurori i Apelit, të akuzuarit F.G. dhe B.T., të dëmtuarit V.L. dhe F.I., e të cilët ishin njoftuar në mënyrë të rregull dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre.

Mbrojtësit e të akuzuarve, mbeten pranë pretendimeve të tyre si në ankesa.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar pretendimet ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.G. dhe B.T., e duke marrë parasysh edhe sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.G. dhe B.T., janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës:

-Mbrojtësit e të akuzuarve F.G. dhe B.T., avokatët F.D. dhe M.N., në ankesat e tyre, e të cilat janë plotësisht identike me njëra tjetrën, pretendojnë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale nga neni 384 par.1 nën par.1.8 dhe 1.12 të KPP, dhe aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.6,7 dhe 8 të KPP. Gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara dhe a ekziston kundërthënie në saktësinë e provave, e veçanërisht rreth ekzistimit të veprave penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe identifikimi i të akuzuarve është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ankesat pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si pasojë e kësaj është shkelur edhe ligji penal në dëm të akuzuarve.

Sipas ankesave edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për arsye se ajo mbështetet në cilësinë e dëshmitarëve V.L., B.R., L.S. dhe F.I., të cilët njëherit janë edhe të dëmtuar, si dhe në vërtetimet mbi marrjen e përkohshme të sendeve, procesverbalin mbi identifikimin e personave dhe raportit të topografisë dhe transkriptet e bisedave telefonike të akuzuarve të dt.20.10.2011.

Në ankesa pretendohet se gjykata nuk është dashur ti falë besimin të dëmtuarve B.R., L.S., F.I., si dhe dëshmisë të dëshmitarit B.B., e që ka të bëjë me identifikimin e personave dhe dëshmime të dëshmitarëve V.Sh., A.Gj. dhe H.K., për arsye se me dëshmitë e tyre nuk kanë mundur të vërtetojnë kryerjen e veprave penale nga të akuzuarit dhe si pasojë e provave në mënyrë të drejtë edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar. Sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal gjykata ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, mirëpo, nuk ka marrë parasysh rrethanat tjera që është dashur t'i merr gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, se të akuzuarit gjatë gjithë procedurës kanë qenë korrekt, janë mbajtës të familjes, se janë të gjendjes jo të mirë shëndetësore, pasi që edhe gjatë mbajtjes në paraburgim kanë pasur probleme shëndetësore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi nën I. që ka të bëjë me veprën penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, në dëm të dëmtuarës V.L., dispozitivat nën III dhe IV, që kanë të bëjnë me veprën penale të grabitjes të kryer në dëm të dëmtuarve B.R., L.S. dhe F.I., në përshkrimet e tyre paraqiten veprimet e të akuzuarve F.G., dhe B.T. lidhur me faktet vendimtare dhe përgjegjësinë penale-juridike të tyre dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe të plota se të akuzuarit kanë përdorur dhunën, ashtu që i akuzuari F.G., e përdor dhunën dhe e kap për krahu dhe e mbështetë për veturë të dëmtuarën V.L., duke iu kanosur dhe duke prezantuar si polic, ndërsa i akuzuari B.T., futet brenda në veturë dhe ia marr tre telefona të tipit "I Phone", "Nokia E 72" dhe një "Nokia", dhe duke përdorur dhunën nga veshi i akuzuari F., ia heqë vathët prej ari në shumë prej 400 € dhe një unazë të arit nga gishti i dorës në vlerës prej 150 €, edhe ndaj të dëmtuarve B.R. dhe L.S. si dhe të dëmtuarit F.I., të akuzuarit përdorin dhunën dhe kanosjen, përderisa të dëmtuarit ishin në veturën e parkuar, të dy të akuzuarit me maska të zeza ofrohen në veturë dhe i akuzuari B.T. ia drejton revolen të dëmtuarit B., e nxjerrë jashtë, duke u prezantuar si polic dhe nga xhepi i të dëmtuarit ia nxjerrin kuletën dhe ia

marrin shumën e të hollave prej 30 €, telefonin në vlerë prej 300 €, ndërsa i akuzuari F.G., e detyron të dëmtuarën të dalin jashtë nga vetura dhe ia merr shumën prej 180 €, si dhe telefonin e tipit "Nokia" në shumë prej 40 €, në mënyrë të njëjtë veprojnë edhe kundër të dëmtuarit F.I., duke u prezantuar si polic dhe duke ia drejtuar revolen e nxjerrin prej veturës dhe nga xhepi ia marrin kuletën në të cilën kishte shumën prej 270 €, dhe telefonin e tipit "Nokia 6300". Lidhur me këto fakte vendimtare gjykata nxjerrë përfundim të drejtë se të akuzuarit F.G. dhe B.T., kanë kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, e kjo mbështetet nga procesverbali i identifikimit të personave – të akuzuarve F.G. dhe B.T., i cili identifikim është bërë në pajtim me nenin 120 të LPP, (i vjetri neni 255), e kjo mbështetet edhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dëshmitarëve-të dëmtuarve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, kjo mbështetet edhe nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve si dhe nga topografit dhe transkriptet e bisedave telefonike të akuzuarve.

Sipas kolegji penal të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përpiluar në pajtim me dispozitat e nenit 365 par. 1 të KPP-së, dhe gjykata ka paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprave penale të përshkruara si në dispozitivet, nën I, III dhe IV, rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarve F.G. dhe B.T., e cila mbështetet në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor dhe provat tjera të cekura më lartë, e nga kjo rezulton se pretendimet ankimore se aktgjykimi është i përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP-së, nuk qëndrojnë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cilat janë cekur më lartë, e në të cilat pretendojnë ankesat e mbrojtësve të akuzuarve se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve nga neni 385 par. 1 të KPP-së, për arsye se nuk është provuar se të akuzuarit janë kryes të veprave penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, në dëm të dëmtuarës V.L., si në dispozitivin I, si dhe të veprave penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par 1 e lidhur me nenin 23 të KPK, si në dispozitivat III dhe IV, e në dëm të dëmtuarve B.R., L.S. dhe F.I. për të cilat vepra janë shpallur fajtorë janë të pabazuara. Sipas kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal dhe ka gjetur se të akuzuarit kanë përdorur dhunën, i akuzuari F.G., e përdor dhunën, të dëmtuarën V.L., e kap për krahu, dhe e mbështetë për veturë, e me të akuzuarin B.T., edhe iu janë kanosur, duke u prezantuar si polic, dhe i akuzuari B.T., futet brenda në veturë dhe ia marr tre telefona të tipit "I Phone", "Nokia E 72" dhe një "Nokia", dhe nga veshi i akuzuarit F., ia heqë vathët prej ari në shumë prej 400 € dhe një unazë të arit nga gishti i dorës në vlerës prej 150€, ndërsa, edhe ndaj të dëmtuarve B.R. dhe L.S., të akuzuarit përdorin dhunën dhe kanosjen, përdërisa të dëmtuarit ishin në veturën e parkuar, të dy të akuzuarit me maska të zeza ofrohen në veturë dhe i akuzuari B.T., ia drejton revolen të dëmtuarit B., e nxjerrë jashtë, duke u prezantuar si polic dhe nga xhepi i të dëmtuarit ia nxjerrin kuletën dhe ia marrin shumën e të hollave prej 30 €, telefonin në vlerë prej 300 €, ndërsa i akuzuari F.G., e detyron të dëmtuarën të dalin jashtë nga vetura dhe ia merr shumën prej 180 €, si dhe telefonin e tipit "Nokia" në shumë prej 40 €, të akuzuarit F.G. dhe B.T., në mënyrë të njëjtë veprojnë edhe kundër të dëmtuarit F.I., duke u prezantuar si polic dhe duke ia drejtuar revolen, e nxjerrin prej veturës dhe nga xhepi ia marrin kuletën në të cilën kishte shumën prej 270 €, dhe telefonin e tipit "Nokia 6300", e me përdorimin e dhunës dhe kanosjes ndaj këtij. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal dhe ka nxjerrë përfundime të drejta se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe dy veprave penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par. 1 e në lidhje me nenin 23 të KPK-së, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të akuzuarit F.G. dhe B.T. kanë kryer veprat penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, në dëm të dëmtuarës V.L., të përshkruar si në dispozitivin I, si dhe të veprave penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par 1 e lidhur me nenin 23 të KPK, të përshkruara si në dispozitivet III dhe IV, e në dëm të

dëmtuarve B.R., L.S. dhe F.I. , dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal , e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë edhe pse ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.G. dhe B.T., pretendojnë nuk është vërtetuar për arsye se nuk është bërë identifikimi i të akuzuarve, dhe se gjykata iu beson dëshmitëve të dëshmitarëve-të dëmtuarve. Sipas kolegjit penal të kësaj gjykate kjo mbështetet nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, nga deponimet e të dëmtuarve V.L., B.R., L.S. dhe F.I., e me të cilat prova vërtetohet se të akuzuarit F.G. dhe B.T., janë kryerës të veprave penale , e këto vërtetohen edhe dheshmit e dëshmitarëve B.B., Agim Xhela, Bashkim Spahiu, H.K. dhe V.Sh. dhe se të akuzuarit si në dispozitivin nën I. e në të cilën e dëmtuar paraqitet V.L., i akuzuari F.G., e ka përdorur dhunën dhe e kap për krahu dhe e mbështetë për veturë të dëmtuarën Valmira, duke iu kanosur dhe duke prezantuar si polic, ndërsa i akuzuari B.T., futet brenda në veturë dhe ia marr tre telefona të tipit "I Phone", "Nokia E 72" dhe një "Nokia", dhe nga veshi i akuzuari F., ia heqë vathët prej ari në shumë prej 400 € dhe një unazë të arit nga gishti i dorës në vlerë prej 150 €, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetohet edhe nga deponimet e dëshmitarëve të cekur më lartë, se edhe ndaj të dëmtuarve B.R. dhe L.S., të akuzuarit përdorin dhunën dhe kanosjen, përdërisa të dëmtuarit ishin në veturën e parkuar, të dy të akuzuarit me maska të zeza ofrohen në veturë dhe i akuzuari B.T. ia drejton revolen të dëmtuarit B., e nxjerrë jashtë, duke u prezantuar si polic dhe nga xhepi i të dëmtuarit ia nxjerrin kuletën dhe ia marrin shumën e të hollave prej 30 €, telefonin në vlerë prej 300 €, ndërsa i akuzuari F.G., e detyron të dëmtuarën të dalin jashtë nga vetura dhe ia merr shumën prej 180 €, si dhe telefonin e tipit "Nokia" në shumë prej 40 €, e po të njëjtën mënyrë veprojnë edhe kundër të dëmtuarit F.I., duke u prezantuar si polic dhe duke ia drejtuar revolen e nxjerrin prej veturës dhe nga xhepi ia marrin kuletën në të cilën kishte shumën prej 270 €, dhe telefonin e tipit "Nokia 6300".

Sipas kolegjit penal të Gjykatës së Apelit se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, mbështetet nga identifikimi i personave – të akuzuarve, dhe nga procesverbalit i dt. 19.10.2011, nga raporti i topografisë dhe transkripteve të bisedave telefonike të dt. 20.10.2011, nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të datave 23.09.2011 dy vërtetime të datës 18.10.2011 dhe një vërtetim mbi marrjen e sendeve të dt. 19.10.2011. nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale, dhe nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, për veprat penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPRK, të kryer në dëm të dëmtuarës V.L., dhe për dy vepra penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par. 1 e në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të kryer në dëm të dëmtuarve B. R., L.S. dhe F.I., pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve F.G. dhe B.T., janë të paqëndrueshme, dhe gjykata e shkallës së parë drejt , ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese për veprat penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor. Edhe Gjykata e Apelit rrethanat rënduese dhe lehtësuese i ka marrë si të vërtetuara e , të cilat rrethana janë vlerësuar drejt nga gjykata e shkallës së parë, dhe dënimet unike me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashhtë) muaj, për secilin të akuzuar janë marrë në pajtim me dispozitën e nenit 76 të KPRK-së, në kuadër të kufijve të zbutjes së dënimeve , dhe dënimet e shqiptuara janë nën minimumin e paraparë ligjor, (duke marrë parasysh se veprat penale janë kryer sipas KPK-kodi i vjetër) e duke marrë parasysh kohëzgjatjen prej momentit të kryerjes së veprës penale e gjerë në vendosjen e kësaj çështje penale, se ka kaluar kohë relativisht e gjatë, dënimet e këtitilla të shqiptuara me burgim janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, dhe me shqiptimin e këtyre dënimeve të njëjtat do t'i shërbejë preventivës individuale që të parandalojë të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale si dhe të bëhet rehabilitimi i tyre, e njëkohësisht dënime e shqiptuara t'i shërbejnë edhe

preventivës së përgjithshme, që edhe të tjerët të përmbahen nga kryerja e veprave penale , dhe me dënimet e këtilla të shqiptuara me burgim, pritet të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë, u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara, e në bazë të nenit 401 të KPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.32/2017, me dt.16.03.2017.

Procesmbajtësi,

Shaqë Curri

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit

Vahid Halili,